

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Muli përgëzon zonjën Karo si regjisore
ADRESA	https://www.gazetatema.net/antena/muli-pergez-on-zonjen-karo-si-regjisore-i587088
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 13:21:23 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 15:30:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0b5c7b9a639906eec9115ba081a55d034c5105a1b93dd7106bd60783f2f4720c
TEKSTI	6a5e19212b391274cf7d6e2cf0023cf837db7cee50109a8106148c85d341a1f7
PAMJA	c05accc70ca4e29c57f098babff7d93e876c82e0c36758586eead21be04d7e01

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9c04848c35d8de26a96d6d6441b1d4109761b560706eb7154ebc7defd807d98a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9c04848c35d8de26a96d6d6441b1d4109761b560706eb7154ebc7defd807d98a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 English

Built and Monetized by 

[Kontakt](#)



 English



le Festivali i himit "DEA OPEN AIR", festivali qe promovon kinematograhme shqiptarePerdhunoj gruan britanike ne nje rruge te Londres dhe me pas e kerkoj ne spital, deno fundit

Muli përgëzon zonjën Karo si regjisore



19 Shtator 2026, 17:30Antena TEMA

Gjatë konferencës së sotme për shtyp u krijua një situatë delikate. Doktorit e kishte të nevojshme të sulmonte ata që e tallnin për mosheqjen e "non grata". Këtë detyrë ia ngarkoi Lelos.

Lelo bisedoi me Mulin se si mund ta inskenonin këtë momentin ku Doktorit duhet t'u turrej atyre që talleshin me këtë punën e "non grata".

Muli thirri zonjën Karo dhe i dha urdhër që t'ia lexonte si pyetje Doktorit.

Zonja Karo refuzoi. Unë jam profesioniste, tha. Nuk mund t'i lexoj pyetjet e sajua vetë. Duhet të më vijë nga një vartës.

Dakord, i tha Muli, do caktosh atë Gertën që ke vartëse të të shkruajë një pyetje ty dhe ti t'ia lexosh Doktorit.

Pastaj përgjigjen e Doktorit do ta zbardhësh sot, t'ia japësh Gertës dhe ta shpërndajë për shtypin.

-Kështu po, tha zonja Karo. Kjo është punë profesioniste.

Dhe ashtu u bë. Gerta bëri pyetjen, zonja Karo e lexoi, Doktorit u përgjigj.

-Stop, Doktor, i tha zonja Karo. Ta bëjmë dhe një dubël ta kemi, se nuk doli mirë zëri në fund.

-Dakord, tha Doktorit. Desha t'i mallkoj këta që gëzohen me fatkeqësinë e tjetrit, por po u them: ju marrtë pas Lubia.

-Jo, jo, hiqe këtë, i tha zonja Karo, se na duhet e pastër kjo skena. Mos na përziej me emra të tjerë. Duhet të sqarojmë që tani nuk je non grata as ti, as teta Lili, as Gita, as Zeni.

-E vërtetë, tha Doktorit. Nuk jemi non grata. Ata e kanë akoma të vështirë të marrin vizë, por do ta zgjidhim. Unë e zgjidha timen, por shkoi diku tek 12 milionë euro, 6 LaCivita, 6 kjo kompania e lobimit. Tani për këta vetë duhen rreth 50 milionë euro. Besoj do t'i gjejmë. Demokratët janë të mobilizuar.

-Atëherë e fillojmë dhe një herë, tha zonja Karo. Vazhdo përgjigjen se pyetjen e kemi.

-Dua t'u them të gjithë atyre që u gëzuan më 2021 për non gratën time, veçanërisht Lul Bashës dhe Ramës: mos bëfshi hajër dhe ju marrtë pas Lubia.

-E the një herë këtë, tha zonja Karo.

-Po a the dubël ti?, pyeti Doktorit.

-E thashë, tha zonja Karo, por që të mos thoshe këtë fjalinë e fundit. Dhe një dubël tjetër e s'të biem më në qafë.

-Dakord, tha Doktorit. Po e përsëris që nuk kam qenë non grata dhe se ai njoftimi në Departament të Shtetit do të hiqet sapo të kthehet nga pushimet IT e Departamentit të Shtetit, se ka ikur në Florida dhe atje ka uragane dhe është vonuar ca. Gjithë të tjerat janë në rregull.



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Muli i kënaqur nga shpjegimet e Doktorit për 6 milionë dollarët e vizës](#)

18:06 Antena / 1 koment

Muli në dilemë për deklaratat e Doktorit për Gjykatën e Hagës


19:18 Antena / 4 komente

Muli i paqartë si duhet të reagojë për Thaçin

20:21 Antena / 7 komente

Muli xheloz për flamingon e ri nga Pekaj

19:19 Antena / 2 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.